

RAPORTI PER FUNDIMTAR PER VLERËSIMIN E JASHTËM (AKREDITIMIN)

E PROGRAMIT TE STUDIMIT “Master Profesional” në “Menaxhim Biznesi” me drejtim “Menaxhim Shëndeti”

2012

Eksperti i vlerësimit
Prof. Asc.Dr. Edmond Pistulli

MAJ 2012

SHKURTIME

ShLUPUMSH - Shkolla e Larte Universitare Private, "Universiteti Mesdhetar i Shqiperise"

APAAL - Agjencia Publike e Akreditimit te Arsimit te Larte

IAL - Institucion i Arsimit te Larte

MASH - Ministria e Arsimit dhe Shkences

KA - Keshilli i Akreditimit

GVJ - Grupi i Vleresimit te Jashtem

GVB - Grupi i Vleresimit te Brendshem

RGVJ - Raporti i Grupit te Vleresimit te Jashtem

RGVB - Raporti i Grupit te Vleresimit te Brendshem

SWOT - Strengths, Weaknesses, Opportunities, and Threats

ENQA - European Association for Quality Assurance in Higher Education

Hyrje

Raporti i Vleresimit të Jashtëm është realizuar pas vizitave në Shkollën e Lartë Private "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare të Shqipërisë"(UMSH), sipas programit të punës të hartuar nga Agjencia Publike e Akreditimit e Arsimit të Lartë (më tej APAAL) dhe Grupi i Vleresimit të Jashtëm (GVJ). Në këtë raport, GVJ është përpjekur të paraqesë në mënyrë të detajuar dhe reale, funksionimin dhe aspekte të tjera të mësimdhënies e mësimnxënies, bazuar në legjislacionin shqiptar të arsimit të lartë si dhe në "Standartet Shtetërore të Cilësisë", "Standarde dhe Udhëzime për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë", Shoqata Europiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA). Organizimi i këtij programi bëhej sipas rregullave të përcaktuara në përputhje me kriteret e Kartës së Bolonjës.

Paraprakisht pasi u krijua një grup pune nga APAAL për vlersimin e ketyre programeve mësimore, dhe ne bashkepunim me institucionin, grupi i punes hartoi një program pune për procesin e vlerësimit ne këtë institucion.

Përbërja e GVJ dhe programi i punës

Grupi i Vleresimit të Jashtëm përbëhej nga :

1. Eksperti i vlerësimit Prof.Asc.Dr.Edmond Pistulli, shef i Departamentit të Diagnostikës, Fakulteti i Infermierisë, Universiteti i Tiranës. Njohës i mirë i kurikulave dhe i programeve të studimit dhe njëkohësisht ekspert i fushës së infermieristikës dhe menaxhimit shëndetsor
2. Përfaqësuesi i APAAL, Edmond Mino, Specialist i Sektorit të Statistikave dhe Analizave

Vizita në institucion u krye në datën 10.05.2012 për Programin e studimit Mp Menaxhim Biznesi me drejtim: Menaxhim Shëndeti , sipas axhendës së miratuar nga APAAL në koordinim me UMSH.

Programi i punës se Grupit të Vlerësimit të Jashtëm u fokusua ne disa drejtime :

1. Takimi me titullarët i UMSH, Administratorin, Rektorin UMSH dhe Dekanin e Fakultetit për njohjen e mënyrës së funksionimi të IAL dhe aspekte të treja drejtuese e organizative. Njohja me statutin dhe rregulloren e shkolles, si edhe materiale te tjera ndihmese per kryerjen e vleresimit te jashtem.
2. Takimi me Grupin e vlerësimit të brendshëm (GVB) dhe njohja me procedurën e hartimit të raportit te vleresimit te brendshem te kryer nga ky grup.
3. Takimi me stafin akademik e administrativ. Njohja me programet mësimore, sylabuset, facilitetet që ofron IAL, planet mesimore dhe kërkimin shkencor.
4. Analiza e rezultateve te nxjerra dhe verifikimi i te dhenave nga UMSH ne raportin e vleresimit te brendshem,

5. Krahasimi i rezultateve me standartet me te mira profesionale në fushën e arsimit mjekesor ne vend e me gjere.

Gjatë punës, grupi i vlerësimit ka mbajtur lidhje të vazhdueshme dhe ka patur ndihmën e të gjithë pedagogëve të Fakulteteve, Rektorit, dhe Dekanit të Fakultetit, si dhe te të gjithë stafit ndihmës të IAL.

Parimet e Punës së GVJ dhe aktivitetet

GVJ, pasi u njoh me dosjen e Vetevleresimit, të hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm, GVB, realizoi viziten ne ambjentet e UMSH, sipas programi të mësipërm

Gjate vizites në UMSH, u kryen keto aktivitete:

1. Takim me Rektorin e Shkollës së Lartë Universitare jo Publike “UMSH” Prof.Dr Anastas Angjeli dhe me administratorin e këtij institucioni ku u prezantua historiku i UMSH, mënyra e funksionimit e drejtimit, orientimi në menaxhimin shëndetsor, pikat e forta dhe problematikat që e shoqërojnë procesin mësimor
2. GVB analizoi punën e bërë për hartimin e raportit duke theksuar objektivizmin në hartimin e tij.
3. Takimi me stafin akademik (efektiv dhe me kontratë) që mbulojnë programin e studimit
4. Përveç procesit të mësimdhënies, takimi me stafin akademik u fokusua në punën kërkimore e shkencore të tyre dhe mbështetjen që u jep UMSH në këtë drejtim.
5. Takim me studentet e institucionit me te cilet u zhvilluan intervista me goje dhe pyetësorë me shkrim, ndihmoi me shumë grupin e punës për të marrë më shumë informacion rreth institucionit.
6. Vizite në ambjentet ku kryhet mesimi: në klasa, sallat e leksioneve, labororet, biblioteke dhe fasiliteve të tjera ne funksion te Programit te Studimit.
7. Takim me stafin administrativ te institucionit.
8. Vizite ne sekretarine mesimore.
9. Takimi mbylles me titullaret e institucionit

Gjithashtu, ne te gjitha takimet që u zhvilluan (me stafin akademik, grupin e vleresimit te brendshem, stafin administrativ dhe studentet) tematika e intervistave u fokusua gjithashtu në:

- Programin mesimor dhe realizimin e tij
- Baza laboratorike e programeve te studimit
- Personelin pedagogjik e ndihmes dhe ngarkesa mesimore
- Format dhe metodat e mesimdhenies
- Vleresimi i stafit
- Studentet dhe niveli i pergatitjes se tyre
- Mjedisi ku kryhet mesimi
- Drejtimi i procesit mesimor

- Faktoret qe garantojne cilesine ne pergatitjen e studenteve.

GVJ iu vunë në dispozicion nje sere dokumentash dhe materialesh shtese si: statute, rregullorja, struktura, raporti i kerkimit shkencor, plani mësimor, dokumente të sekretarisë mësimore, kontrata studenti etj

Metodologjia e hartimit të këtij raporti bazohet në legjislacionin shqiptar të arsimit të lartë si dhe në “Standartet Shtetërore të Cilësisë”, për Institucionet e Arsimit të Lartë dhe Standardet e Akreditimit të Programeve të Studimeve të Ciklit të dytë.

Të dhëna për institucionin e arsimit të lartë, Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë, (UMSH)

UMSH, është licensuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr.177, datë 19.2.2009 “Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë" Ky institucion ushtron veprimtarinë në qytetin e Tiranës dhe në tri fakultete:

- a) Fakulteti i Shkencave Politike
- b) Fakulteti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare
- c) Fakulteti i Shkencave Ekonomike

Në çdo fakultet ishin organizuar këshillat e fakulteteve dhe strukturat e tjera përbërëse.

Në Fakultetin e Shkencave Ekonomike studimet në programet master Profesional ne Menaxhim Biznesi ishin të organizuar sipas drejtimeve të mëposhtme:

- Menaxhim turizmi
- Menaxhim i pasurisë së paluajtshme
- Menaxhim i artit
- Menaxhim i shëndetit
- Menaxhim i arsimit

Përgjegjës për zhvelimin e programeve është ky fakultet dhe në veçanti Departamenti Menaxhimit. Koordinator i programit Master ne Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Shëndeti ishte dhe përgjegjësi i departamentit.

Organizimi i programit është në përputhje me standartet dhe kriteret shtetërore të cilësisë, legjislacion shqiptar të arsimit të lartë dhe Kartës së Bolonjës.

Fokusimi kryesor për vlersimin e programit ishte në Departamentin perkates, por pa anashkaluar edhe funksionimin në tërësi të fakultetit dhe IAL në tërësi.

Tabela format	
Për vlerësimin e jashtëm	
të programit të studimit MP në “Master Profesional” në “Menaxhim Biznesi” me drejtim “Menaxhim Shëndeti” mbështetur në Standardet shtetërore për programet e studimit të Ciklit të Dytë	
Standardet/kriteret	Mendimi i GVJ për përmbushjen e standardit/kriterit¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1	
- Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Intitucioni ofron programe të akredituara të studimeve sipas sistemit Europian të transferimit dhe grumbullimit të krediteve(ECTS)
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Një program studimi me kohë të plotë për një vit është 60 kredite
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Programet janë të hartuara në përputhje me qëllimet e misionin e Institucionit
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Mendoj se programet e Studimeve janë Hartuar në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	Programet e Studimeve janë hartuar kompatible me zhvillimin ekonomik të vëndit
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	Mendoj se programet pasqyrojnë ruajtjen e vlerave kulturore të kombit
Konkluzione:	
Programet janë të hartuara në përputhje me qëllimet e misionin e Institucionit, i cili ofron programe të organizuara në module, me 60 kredite për një vit, programet janë të hartuara kompatible me nevojat e tregut të punës.	
Standardi I.2	
- Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit	Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të Institucionit.

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha kriteret. Në fund të kriterëve duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p>	<p>Mendoj se programet e studimeve të ciklit të II i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara teorike dhe praktike.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p>	<p>Programet e studimeve Master kanë si qëllim të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e I të studimeve.</p>
<p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p>	<p>Institucioni nuk i ofron programet e integruara të studimeve të ciklit të II (mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë).</p>
<p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p>	<p>Institucioni nuk i ofron programet e integruara të studimeve të ciklit të II (mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë).</p>
<p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p>	<p>Institucioni nuk përfshin master shkencor në Menaxhim Shëndeti.</p>
<p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimeve “Master Profesional” në Menaxhim Shëndeti paraqet objektiva profesional, të justifikueshëm për kualifikimin e nevojshëm të studentëve në lidhje me kërkesat e tregut të punës.</p>
<p>Konkluzione: Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të Institucionit dhe programi i studimit “Master Profesional” paraqet objektiva</p>	

profesional për kualifikimin e studentëve në lidhje me kërkesat e tregut të punës.	
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;	Mendoj se përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.	Mendoj se emërtimi i programit ka kompatibilitet me nivelin e kualifikimit të përcaktuar nga KSHK.
Konkluzione: Mendoj se përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.	
Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;	Programet e studimeve të këtij institucioni janë në përputhje me nivelin në të cilin ofrohen.
Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.	Mendoj se metodatat e vlerësimit të studentëve pasqyrojnë ecurinë në programet e studimit të Menaxhimit të Shëndetit.
Konkluzione: Programet e studimeve të këtij institucioni janë në përputhje me nivelin në të cilin ofrohen dhe pasqyrojnë ecurinë e programit të studimit të Menaxhimit të Shëndetit.	
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	
Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane.	Megjithëse profili Menaxhim Shëndeti është degë e re, ai përpiqet të mbështetet në përvojën dhe praktikatat e mira të vendeve europiane.
Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e	Programet e studimit të Menaxhim Shëndetit janë të krahasueshme me programet e studimeve ndërkombëtare për nga elementët që përmbajnë duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri.

arsimit universitar në Shqipëri;	
Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.	Programet e studimit të Menaxhim Shëndetit janë në përputhje me direktivat e BE-së.
Konkluzione: Megjithëse profili Menaxhim Shëndeti është degë e re, ai mbështetet në përvojën dhe praktikat e mira të vendeve europiane.	
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;	Programet e studimit të Menaxhim Shëndetit përfshijnë teorikisht aftësim profesional, por duhet të kihet parasysh implementimi i një praktike në institucione shëndetësore të studentëve të këtij profili.
Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;	Programet e studimeve të Menaxhim Shëndetit kanë përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë.
Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;	Personeli akademik duhet të angazhohet më shumë në punën kërkimore shkencore të profilit të Menaxhim Shëndeti.
Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.	Duhet insistuar që puna kërkimore e Menaxhim Shëndetit të jetë e lidhur drejtpërdrejt me qëllimet e synuara në këtë profil.
Programet e studimit të Menaxhim Shëndetit përfshijnë teorikisht aftësim profesional, por duhet të kihet parasysh implementimi i një praktike në institucione shëndetësore të studentëve të këtij profili. Personeli akademik duhet të angazhohet më shumë në punën kërkimore shkencore të profilit të Menaxhim Shëndeti.	
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Personeli akademik duhet të angazhohet më shumë në punën kërkimore shkencore të profilit të Menaxhim Shëndeti.
Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.	Programet e studimeve të ciklit të II në “Master Profesional” të Menaxhim Shëndetit, megjithëse një degë e re në vendin tonë synon të plotësojë

	mangësitë që ndjehen në menaxhimin shëndetësor.
Konkluzione: Personeli akademik duhet të angazhohet më shumë në punën kërkimore shkencore të profilit të Menaxhim Shëndeti.	
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;	Institucioni, aktualisht nuk pasqyron të dhëna konkrete, në lidhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.
Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin: a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.	Institucioni ka për detyrë të kryejë studimin e tregut, kryesisht vendas për punësimin e studentëve të profilit të menaxhim Shëndeti. Institucioni nuk ka të dhëna për numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucione të tjera pasi kjo është një degë e re në vendin tonë.
Konkluzione: Institucioni, aktualisht nuk pasqyron të dhëna konkrete, në lidhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar. Institucioni ka për detyrë të kryejë studimin e tregut, kryesisht vendas për punësimin e studentëve të profilit të menaxhim Shëndeti. Institucioni nuk ka të dhëna për numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucione të tjera pasi kjo është një degë e re në vendin tonë.	
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;	Programet e studimit të Menaxhim Shëndetit nuk bien ndesh me interesat kombëtare.
Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	Programet e studimit në master Profesional të Menaxhim Shëndetit nuk ndikojnë drejtpërdrejt në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.
Konkluzione: Programet e studimit të Menaxhim Shëndetit nuk bien ndesh me interesat kombëtare	
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe	

vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	Metodologjia e vlerësimit në Menaxhim Shëndeti është e përshtatshme me ecurinë e programeve të studimit.
Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;	Raporti i vetëvlerësimit të brendshëm e përfshin këtë informacion.
Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;	Rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë, publikohen nga institucioni.
<p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare /ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.); 	<p>Në vlerësimin e tërthortë Menaxhim Shëndeti si degë e re, nuk ka të dhëna të të diplomuarve të viteve të mëparshme, ndërsa për sa i përket sondazheve të vlerësimit të mësimdhënies institucioni përdor metoda të tilla si pyetje konceptuale, intervista etj.</p> <p>Për sa i përket metodave të drejtpërdrejta keto realizohen nëpërmjet dëgjimeve në auditor dhe në provimet e vlerësuara me notë, të dokumentuara në regjistrat në sekretari dhe on-line gjithashtu institucione realizon detyra kursi, diskutime praktike dhe opinione nga studentët që finalizohen me mbrojtjen e një mikroteze të caktuar në lidhje me profilin e Menaxhimit të Shëndetit.</p>

<p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	
<p>Konkluzione:</p> <p>Metodologjia e vlerësimit në Menaxhim Shëndeti është e përshtatshme me ecurinë e programeve të studimit megjithëse nuk ka të dhëna të të diplomuarve të viteve të mëparshme në mësimdhënie përdor metoda vlersimi nëpermjet pyetjeve konceptuale dhe vlersimit të drejtpërdrejtë me notë.</p>	
<p>Standardi I.11</p> <p>- Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Institucioni ka hartuar një plan strategjik, modest, për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të menaxhim shëndetit.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një plan për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies.</p>
<p>Konkluzione:</p> <p>Institucioni ka hartuar një plan strategjik, modest, për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të menaxhim shëndetit.</p>	
<p>Standardi I.12</p> <p>- Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Institucioni nuk ka hapur programe studimi “Master Shkencor” në degë Menaxhim Shëndeti.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Programi i studimeve “Master Profesional” në Menaxhim shëndeti përmban 60 kredite dhe zgjat një vit akademik.</p>

<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>Institucioni nuk ka hapur programe studimi “Master Shkencor” në degë Menaxhim Shëndeti.</p>
<p>Konkluzione: Institucioni ka hartuar një plan strategjik, modest, për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të menaxhim shëndetit.</p>	
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p>	<p>Institucione ka hartuar plane për botimin e broshurave dhe buletineve për vlerësimin e brendshëm, por që duhet të botohen sa më shpejt për të ritur nivelin shkencor të studentëve.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj., për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Institucioni publikon prezantime të formateve të ndryshme në faqe interneti.</p>
<p>Konkluzione: Institucioni ka hartuar një plan strategjik, modest, për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të menaxhim shëndetit.</p>	
<p>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I INSTITUCIONIT BËHET NË PËRPTHJE ME NEVOJAT E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE.</p>	
<p>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p>	<p>Personeli akademik, ndihmës mesimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për të ndihmuar studentët e profilit Menaxhim Shëndetit</p>
<p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli i institucionit paraqet angazhim në lidhje me strategjinë e zhvillimit të vetë institucionit.</p>
<p>Konkluzione: Personeli akademik, ndihmës mesimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për të ndihmuar studentët e profilit Menaxhim Shëndetit</p>	
<p>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</p>	

Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	Institucioni paraqet angaxhim për realizimin e misionit të tij.
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;	Ky institucion përfshin 3 fakultete.
Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;	Fakultetet janë të organizuara sipas Ligjit të Arsimit të Lartë.
Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;	Fakultetet janë të organizuara sipas Ligjit të Arsimit të Lartë.
Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".	Në profilin menaxhim Shëndeti dy pedagogët e profilit janë me doktoraturë dhe master.
Konkluzione: Institucioni paraqet angaxhim për realizimin e misionit të tij. Fakultetet janë të organizuara sipas Ligjit të Arsimit të Lartë.	
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;	Për realizimin e programeve të studimeve Njësitë bazë janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë
Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.	Në procesin e rekrutimit të personelit akademik përfshihen njësitë bazë.
Konkluzione: Për realizimin e programeve të studimeve Njësitë bazë janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë dhe përfshihen në rekrutimin e personelit akademik.	
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;	Hartimi i kurrikulës të programeve të studimit realizohet nga personeli akademik.
Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Rekrutimi i personelit akademik dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
Konkluzione: Për realizimin e programeve të studimeve Njësitë bazë janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë	
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të	

integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	Mjedisi ku zhvillohet veprimtaria mësimore dhe administrative ka një vendodhje të përhershme.
Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	Mjediset e institucionet janë në dispozicion të tyre.
Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;	Ky institucion ka një godinë ku zhvillon programin e studimit dhe siguron menaxhim efikas për arritjen e standardeve.
Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.	Për profilin Menaxhim Shëndeti, praktikat realizohen në mjedise shëndetësore jashtë godinës.
Konkluzione: Për realizimin e programeve të studimeve Njësitë bazë janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë Për profilin Menaxhim Shëndeti, praktikat realizohen në mjedise shëndetësore jashtë godinës.	
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;	Informacioni për programet e studimeve, moduleve e silabuseve është lehtësisht i konsultueshëm për studentët.
Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Informacioni për programet e studimit ofrohet në formën e leksioneve.
Konkluzione: informacioni është lehtësisht i konsultueshëm për studentët.	
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Profili Menaxhim Shëndeti është në vitin e parë të mësimdhënies dhe nuk është kryer analizë vjetore.

Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	Institucioni harton politika për përmirësimin e programeve të ciklit të dytë.
Konkluzione: Profili Menaxhim Shëndeti është në vitin e parë të mësimdhënies dhe nuk është kryer analizë vjetore.	
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;	Plani i diplomimit jep të dhëna mbi mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve.
Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	Ky institucion nuk ka të hapur “Master Shkencor” për profilin Menaxhim Shëndeti.
Konkluzione: Plani i diplomimit jep të dhëna mbi mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve. Ky institucion nuk ka të hapur “Master Shkencor” për profilin Menaxhim Shëndeti.	
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	
Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifatat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	
Konkluzione:	
III - PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PËRBËHET NGA PERSONELI AKADEMIK, PERSONELI NDIHMËS MËSIMORSHKENCOR DHE PERSONELI ADMINISTRATIV.	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	

Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Institucioni, për rekrutimin e personelit ndjek procedura ligjore.
Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;	Personeli akademik i punësuar, në profilin Menaxhim Shëndeti ishte i punësuar me kohë të pjesshme.
Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	Vlerësimi i personelit bëhet nëpërmjet procedurave ligjore.
Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.	Institucioni ka informacion mbi rekrutimin e personelit.
Konkluzione:	
Institucioni, për rekrutimin e personelit ndjek procedura ligjore	
Personeli akademik i punësuar, në profilin Menaxhim Shëndeti ishte i punësuar me kohë të pjesshme	
Standardi III.2	
- Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.	
Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;	Në degën Menaxhim Shëndeti përgjegjësi i programit kishte gradën shkencore “Doktor”
Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	Programi i studimit në Menaxhim Shëndeti nuk ka “Master Shkencor”.
Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;	Pedagogët e lëndës në Menaxhim Shëndeti kanë gradën doktor dhe diplomën Master.
Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;	

Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.	Në profilin menaxhim Shëndeti, institucioni siguron personel për udhëheqjen e praktikave profesionale.
Konkluzione: Në degën Menaxhim Shëndeti përgjegjësi i programit kishte kualifikimin e përcaktuar.	
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;	Personeli akademik i profilit Menaxhim Shëndeti ka publikuar materiale shkencorë për këtë profil.
Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Personeli akademik, me anë të angazhimeve jep ndihmesë në zhvillimin e sektorëve përkatës.
Konkluzione: Personeli akademik i profilit Menaxhim Shëndeti ka publikuar materiale shkencorë për këtë profil.	
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;	Në programin e studimit Menaxhim Shëndeti nuk ofrohet mësimdhënia në gjuhë të huaj.
Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Në programin e studimit Menaxhim Shëndeti nuk ofrohet mësimdhënia në gjuhë të huaj.
Konkluzione: Në programin e studimit Menaxhim Shëndeti nuk ofrohet mësimdhënia në gjuhë të huaj.	
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;	Studentët e programit të studimit me profil Menaxhim Shëndeti kanë një ushëheqës për tezën që përgatisin për marrjen e diplomës.
Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	Po, udhëheqësi ka gradë shkencore “Doktor”.

<p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Udhëheqësi i programit të studimit Menaxhim Shëndeti nuk udhëheq më shumë se 5 studentë njëkohësisht.</p>
<p>Konkluzione: Studentët e programit të studimit me profil Menaxhim Shëndeti kanë një ushëheqës për tezën që përgatisin për marrjen e diplomës.</p>	
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p>	<p>Fusha studimore e udhëheqësit i përshtatet fushës studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p>
<p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Udhëheqësi ka njohuri relativisht të avancuara mbi fushën e Menaxhimit të Shëndetit.</p>
<p>Konkluzione: Fusha studimore e udhëheqësit i përshtatet fushës studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p>	
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p>	<p>Profili i Menaxhim Shëndetit nuk përmban orë laboratorike në institucion.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Burimet njerëzore janë të mjaftueshme për përmbushjen e objektivave të programit të studimit të Menaxhim Shëndetit.</p>
<p>Konkluzione: Burimet njerëzore janë të mjaftueshme për përmbushjen e objektivave të programit të studimit të Menaxhim Shëndetit.</p>	
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	

Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;	Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.	Programet e studimit të ciklit të dytë dhe ngarkeja mësimore vlerësohen me orë mësimore.
Konkluzione: personeli akademik realizon ngarkesën mësimore dhe vlerësohet me orë mësimore.	
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;	Institucioni ka informacion për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në profilin Menaxhim Shëndeti.
Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;	Institucioni disponon listën e personelit akademik dhe personelit ndihmës të profilit Menaxhim Shëndetit.
Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.	Rekrutimi i personelit akademik realizohet nga kriteret e përcaktuara nga institucioni.
Konkluzione: personeli akademik realizon ngarkesën mësimore, rekrutimi i tij bëhet në bazë të kriterëve të përdaktuara nga institucioni	
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;	Institucioni organizon programe për kualifikimin e personelit akademik dhe joakademik.
Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	Institucioni i ofron personelit akademik kualifikime brenda vendit në degën Menaxhim Shëndeti.
Konkluzione: Institucioni organizon programe për kualifikimin e personelit akademik dhe joakademik.	
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	Institucioni ka një bazë relativisht të pakët të dhënash për studimet shkencore të personelit akademik të profilit Menaxhim Shëndetit.

<p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p>	<p>Aktualisht institucioni nuk disponon bazë të dhënash për botimet të profilit Menaxhim Shëndetit meqënëse kjo është degë e re dhe është viti i I i mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Institucioni nuk ka të dhëna për personelin akademik të profilit Menaxhim Shëndeti për projekte kërkimore shkencore brenda institucionit.</p>
<p>Konkluzione: Institucioni ka një bazë relativisht të pakët të dhënash për studimet shkencore të personelit akademik të profilit Menaxhim Shëndetit. Aktualisht institucioni nuk disponon bazë të dhënash për botimet të profilit Menaxhim Shëndetit meqënëse kjo është degë e re dhe është viti i I i mësimdhënies.</p>	
<p>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</p>	
<p>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p>	<p>Studentët që ndjekin “Master Profesional” në profilin Menaxhim Shëndeti zotërojnë diplomën “Bachelor”.</p>
<p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p>	<p>Në institucion Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p>	<p>Studentët në Menaxhim Shëndeti plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucioni.</p>
<p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve; Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe</p>	<p>Për studentët që ndjekin “Master Profesional” në Menaxhim Shëndeti niveli i gjuhës angleze është B2.</p>

harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.	
Konkluzione:	
Në përgjithësi institucioni mbron të drejtat e studentëve	
Standardi IV. 2	
- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.	
Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;	Aktualisht informacioni për mundësinë e punësimit pas diplomimit në profilin e Menaxhim Shëndetit është i varfër.
Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;	Studentët kanë informacion për akreditimin dhe programet e studimit që u ofrohen.
Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.	Në profilin Menaxhim Shëndetit studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.
Konkluzione:	
Aktualisht informacioni për mundësinë e punësimit pas diplomimit në profilin e Menaxhim Shëndetit është i varfër	
Standardi IV. 3	
- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;	Nuk ka përfunduar ende brezi i I i “Master Profesional” në Menaxhim Shëndeti. Prandaj nuk dihet numri i të diplomuarve
Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;	Institucioni disponon statistika për studentët e regjistruar në profilin Menaxhim Shëndeti.
Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.	Institucioni ka të dhëna për ecurinë akademike të studentëve të profilit Menaxhim Shëndeti.
Konkluzione:	
Nuk ka përfunduar ende brezi i I i “Master Profesional” në Menaxhim Shëndeti. Prandaj nuk dihet numri i të diplomuarve	

Standardi IV. 4	
- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;	Nuk ka përfunduar ende brezi i I i “Master Profesional” në Menaxhim Shëndeti.
Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.	Për profilin Menaxhim Shëndeti nuk ka të dhëna për studentë që vazhdojnë në ciklet e tjera të studimeve.
Konkluzione:	
Nuk ka përfunduar ende brezi i I i “Master Profesional” në Menaxhim Shëndeti.	
Standardi IV. 5	
- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;	Studentët e Menaxhim Shëndetit marrin një informacion të plotë për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit.
Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;	Studentët e Menaxhim Shëndetit informohen për rezultatet e vlerësimit të tyre.
Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.	Përgjegjësi i modulit diskuton me studentët rezultatet e vlerësimeve.
Konkluzione:	
Studentët e Menaxhim Shëndetit marrin një informacion të plotë për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit.	
Standardi IV. 6	
- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;	Institucioni u ofron këshillim studentave të Menaxhim Shëndetit në lidhje me procesin mësimor.
Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	Institucioni orjenton studentët për përzgjedhjen e institucionit ku do të zhvillohet praktika profesionale.
Konkluzione:	
Institucioni u ofron këshillim studentave të Menaxhim Shëndetit në lidhje me	

proçesin mësimor	
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1	
- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;	Konkretisht tekstet mësimoretë mirëfillta për profilin Menaxhim Shëndeti, nuk ka në institucion por jepen nëpërmjet leksioneve.
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;	Bibloteka nuk ka literaturë të mjaftueshme për profilin Menaxhim Shëndeti.
Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;	Institucioni ka librari elektronike, por të pakët për profilin Menaxhim Shëndeti.
Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;	Institucioni duhet të insistojë për shtimin e buxhetit, për shtimin e zërave të bibliotekës të profilit Menaxhim Shëndeti.
Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.	Oraret e bibliotekës janë të përshtatshme me oraret e programeve të studimeve.
Konkluzione:	
Konkretisht tekstet mësimoretë mirëfillta për profilin Menaxhim Shëndeti, nuk ka në institucion por jepen nëpërmjet leksioneve. Institucioni duhet të insistojë për shtimin e buxhetit, për shtimin e zërave të bibliotekës të profilit Menaxhim Shëndeti.	
Standardi V. 2	
- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.	
Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;	Institucioni disponon klasa me pajisje të teknologjisë së informacionit, të mjaftueshme për zhvillimin e mësimdhënies në profilin Menaxhim Shëndeti.
Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;	Pajisjet janë të përshtatshme për mësimdhënie, në përputhje me qëllimin e programit.

<p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p>	<p>Programi Menaxhim Shëndeti nuk parashikon praktika laboratorike.</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Programi Menaxhim Shëndeti nuk parashikon praktika laboratorike.</p>
<p>Konkluzione: Institucioni disponon klasa me pajisje të teknologjisë së informacionit, të mjaftueshme për zhvillimin e mësimdhënies në profilin Menaxhim Shëndeti.</p>	
<p>Standardi V. 3 - Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p>	<p>Institucioni ka realizuar marrëdhënie bashkëpunimi me spitalin “Hygea” për kryerjen e praktikave të studentëve të profilit Menaxhim Shëndeti.</p>
<p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Institucioni nuk ka të hapur programin e studimit të “Master i Shkencave” në profilin Menaxhim Shëndeti.</p>
<p>Konkluzione: Institucioni ka realizuar marrëdhënie bashkëpunimi me spitalin “Hygea” për kryerjen e praktikave të studentëve të profilit Menaxhim Shëndeti.</p>	
<p>VI - INSTITUCIONI KA DHE MENAXHON BURIMET FINANCIARE</p>	
<p>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.;</p>	
<p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një</p>	

qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.	
Konkluzione:	
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1	
- Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;	Institucioni nxit bashkëpunimin nëpërmjet personelit në sajë të shkëmbimit të informacionit.
Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.	Ka marrëdhënie bashkëpunimi mes personelit akademik në profilin Menaxhim Shëndeti.
Konkluzione:	
Po, Institucioni nxit bashkëpunimin nëpërmjet personelit në sajë të shkëmbimit të informacionit.	
Standardi VII.2	
- Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;	Institucioni nuk ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione jashtë vendit por vetëmbrenda vendit në profilin Menaxhim Shëndeti.
Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;	Nuk ka përfunduar ende viti i I i mësimdhënies në Menaxhim Shëndeti në programin “Master Profesional”.
Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;	Nuk ka përfunduar ende viti i I i mësimdhënies në Menaxhim Shëndeti në programin “Master Profesional”.
Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Nuk ka përfunduar ende viti i I i mësimdhënies në Menaxhim Shëndeti në programin “Master Profesional”.
Konkluzione:	
Institucioni nuk ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione jashtë	

vëndit por vetëm brenda vendit në profilin Menaxhim Shëndeti.	
VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË	
Standardi VIII.1	
- Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;	Institucioni është akredituar në nivel institucional
Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;	Përdor instrumente efikase për cilësinë e mësimdhënies.
Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;	Ndjek procedura për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të profilit menaxhim shëndeti.
Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;	Përdor mekanizma për shqyrtimin e herpashershëm të programeve të studimit.
Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;	Institucioni synon ndërgjegjësimin e studentëve për programet e Menaxhim Shëndetit.
Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.	Institucioni harton strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në degën e Menaxhim Shëndeti.
<u>Konkluzione:</u>	
Përdor instrumente efikase për cilësinë e mësimdhënies	

Analiza SWOT për Implementimin e Programit të Studimit

Pikat e forta

1. Edhe pse insitucioni është relativisht i ri, është për tu vlerësuar infrastruktura në funksion të programit të studimit, labororet dhe facilitete në funksion të mësimdhënies
2. Numri ivogël i studentëve që studiojnë në këtë program studimi, është një avantazh që ndikon në cilësinë e mësimdhënies dhe punës me studentët, udhëheqjen, praktikat profesionale etj
3. Asistenca nga IAL ndaj studentëve që studiojnë në këtë program për punësimin dhe orientimin drejt tregut të punës, është për t'u vlerësuar dhe ndihmon mjaft studentët.

4. Organizmi i programit të studimit është konceptuar në përputhje me të gjitha kriteret dhe standardet kombëtare dhe ligjin e arsimit të lartë duke dhënë një shpërndarje të drejtë të ngarkesës së studentëve në auditor dhe pune të pavarur.

Pikat e dobëta

1. Institucioni duhet të fokusohet në rishpërndarjen e ngarkesës mësimore duke u fokusuar më shumë në lëndët/modulet kryesisht të profilit.

2. Edhe pse institucion relativisht i ri dhe programi është në vitin e parë të diplomimit, IAL duhet të fokusohet më shumë në kërkimin shkencor të studentëve që studiojnë në këtë program studimi.

3. Stafi akademik në tërësi mbulon ngarkesën mësimore të programit të studimit por është e nevojshme të ndiqen politika afatgjate të rekrutimit të stafit akademik me profil të menaxhimit të shëndetit bazuar në eksperiencat me të mira kombëtare e ndërkombëtare.

Kërcënimet

Institucioni në politikat afatgjate të tij parashikon zhvillim të infrastrukturës, për programin dhe elementë mbështetës të tij por mosrealizimi i disa aspekteve të rëndësishme që kanë të bëjnë kryesisht me orientimin drejtë të programit kërkimin shkencor dhe stafin akademik më të kualifikuar, mund të ulë cilësinë e mësimdhënies në këtë IAL. Prandaj e shoh të nevojshme fokusimin e politikave afatmesme të IAL në këto drejtime kryesore.

Oportunitetet

Oportunitete kryesore për programin dhe IAL janë në shumëplanshe por kryesisht ato infrastrukturës, profilin e studimeve, kërkesën e tregut të punës për të diplomuar në këtë profil studimi si dhe asistenca e bështetja për studentët nga IAL

Rekomandimet

Në vlerësimin përfundimtar të ekspertit të vlerësimi të jashtëm në lidhje me funksionimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit Master Profesional në Menaxhim Biznesi me drejtim “Menaxhim Shëndeti” jap këto rekomandime:

1. IAL të rishohë shpërndarjen e lëndëve/moduleve/krediteve, literaturës bashkohore në lidhje me profilin e programit të studimit duke pasur parasysh profilin specifik të menaxhimit të shëndetit.

2. Institucioni të fokusohet më shumë në rritjen e nivelit të kërkimit shkencor, të përfshijë më shumë studentët në tësi detyrim që ka ky nivel studimesh

3. Stafi akademik ka nevojë të kualifikohet në drejtimin e menaxhimit të shëndetit si dh etë ndiqen politika rekrutimi në të ardhmen për më të specializuar
4. Të synohet rritja e nivelit të bashkëpunimit me grupet e interesit dhe sektorin shëndetsor.
5. Të vendoset si kriter specifik për pranimin e studentëve në këtë program studimi, gjuha e huaj angleze si detyrim ligjor.

Nga sa më sipër, duke patur parasysh dhe rekomandimet e dhëna, mëndojsë Institucioni i Arsimit të Lartë, Shkolla e Lartë Mesdhetare e Shqipërisë, për programin e studimit “Master Profesional” në “Menaxhim Biznesi” me drejtim “Menaxhim Shëndeti”, i plotëson standartet dhe kriteret për akreditimin e e këtij programi studimi dhe i propozoj Këshillit të Akreditimit që të akreditojë këtë program studimi dhe njëkohësisht ti dërgojë IAL rekomandimet e mësipërme.

Eksperti i vlerësimit të jashtëm për programin “Master Profesional” në “Menaxhim Biznesi” me drejtim “Menaxhim Shëndeti”

Prof.Asc.Dr. Edmond Pistulli,

Tiranë maj 2012